



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 64.2, pika (a dhe b) të Ligjit Nr. 03/L 073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 12.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës

- I. Miratohet Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2021, për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës.
- II. Udhëzimi Administrativ Nr.01/2021, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 12.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 42/2021, i datës 11.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 12.01.2021, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2021

PËR VERIFIKIMIN E APLIKACIONEVE PËR REGJISTRIM PËR VOTIM JASHTË KOSOVËS

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të rregullojë hapat përgjatë procesit të verifikimit të aplikacioneve për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës dhe do të shërbejë si dokument, i cili do të përdoret nga Sekretariati i KQZ-së gjatë procesit të verifikimit të aplikacioneve jashtë Kosovës.

Neni 2

Aplikimi përmes adresës elektronike (e-mail)

- 2.1. Prej një adrese elektronike (e-mail) aplikuesi mund të aplikojë për vete dhe për rrethin e ngushtë familjar.
- 2.2. Nëse prej një adrese elektronike dërgohen aplikacione për regjistrim, të cilat përmbajnë më shumë se dy mbiemra të ndryshëm, KQZ-ja do t'i kthej njoftimin e-mailit që i ka dërguar këto aplikacione për regjistrim, ku njoftimi do të përmbajë tekstin se aplikacionet për regjistrim nuk do të procedohen, duke e dhënë shpjegimin se aplikacionet për regjistrim duhet të dërgohen personalisht dhe për rrethin e ngushtë familjar.

Neni 3

Verifikimi i aplikacioneve për regjistrim

- 3.1. Sekretariati i KQZ-së, do të bëjë verifikimin e dokumentacionit për të gjitha aplikacionet për regjistrim për votim jashtë Kosovës.
- 3.2. Verifikimi i dokumentacionit për të gjitha aplikacionet do të bëhet duke ju referuar Rregullës Zgjedhore Nr. 03/ 2013, nenit 3.1, 3.2, 3.3 dhe 7.2, të kriteve të zotësisë juridike dhe Vendimit të KQZ-së Nr. 42 – 2021, datë 11.01.2021.
- 3.3. Në formularin e aplikimit për regjistrim, përveç të dhënave të tjera aplikuesi duhet të shënojë edhe numrin e tij të telefonit.
- 3.4. Sekretariati do të verifikoj procesin e aplikimit për regjistrim duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit.
- 3.5. Kontaktimi i aplikuesve përmes telefonit do të ndahet në tri faza:
 - a) Thirrja e parë realizohet në orarin e punës sipas kohës lokale në Kosovë;
 - b) Nëse aplikuesi nuk e hap telefonin do të bëhen tentime tjera gjatë orarit të rregullt të punës sipas kohës lokale të shtetit të vendbanimit ku gjendet aplikuesi i shënuar në aplikacion;
 - c) Nëse aplikuesi nuk e hap telefonin sipas pikës (b) do të bëhet tentim edhe pas orarit të rregullt të punës sipas kohës lokale të shtetit të vendbanimit ku gjendet aplikuesi i shënuar në aplikacion;

Neni 4

Vendosja dhe raportimi

- 4.1. Sekretariati, KQZ-së do t'i dorëzoj raportin me përmbledhje të rasteve me aplikacione të dyshimta dhe të pakonfirmuara dhe rekomandimin për vendimmarrje.
- 4.2. Në rastet e dështimeve të verifikimit përmes telefonit, si dhe në rastet kur nuk konfirmohet aplikimi, Sekretariati i rekomandon KQZ-së rastet për vendimmarrje.

Neni 5
Denoncimi i rasteve të keqpërdorimeve në Prokurorinë e Shtetit

KQZ do të njoftoj Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës për rastet e dyshimta për mashtrim të organizuar.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

